

Senati miratën Pam Bondin,
ditë të zeza për Jack Smithin
dhe Gjykatën Speciale I FAQE 5



Shkruan: Astrit GASHI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

RAPORTI I OJQ-ve: GJASHTËMBËDHJETË KANDIDATË PËR DEPUTETË ME AKTAKUZA AKTIVE I FAQE 3



Gjashtëmbëdhjetë kandidatë për deputetë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit kanë aktakuza aktive, u tha në një raport të organizatave joqeveritare të paraqitur të enjten. Sipas

raportit të OJQ-ve, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Lëvizja FOL dhe INPO, nga 16 kandidatë, tre prej tyre kanë më shumë se një aktakuzë aktive. Numri i aktakuzave ndaj tyre arrin në 20,

ndërkaq numri i veprave penale në 21. Me aktakuzë aktive, Lëvizja Vetëvendosje ka në listë tetë kandidatë, Koalicioni AAK-Nisma shtatë dhe LDK-ja një kandidat për deputet

**KOSOVË,
(PA)BARAZIA
GJINORE NË
PROGRAMET
DHE FUSHATËN
ZGJEDHORE F.5**



**KAMERAT E SIGURISË
PËR ZGJEDHJE NË
KOSOVË NGA SERBIA F.7**

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



**UKRAINA I PRANON AVIONËT E PARË
LUFTARAKË FRANCEZË MIRAGE 2000 F.2**

**DNV: NGJYRA MATRIKULUESE
E BLERË PËR ZGJEDHJE NUK
I PLOTËSON STANDARDET F.3**

**SHKELJET GJATË FUSHATËS
ZGJEDHORE, PZAP-i GJOBIT ME
MIJËRA EURO PDK-NË, AAK-në
DHE KOALICIONIN VAKAT F.7**

EKONOMI



**BQK-ja SHTON DY SHËRBIME
FINANCIARE NË PLATFORMËN
SHTETËRORE EKOSOVA F.8**

**SHPENZIMI I PARAVE PUBLIKE
NË KOSOVË: ÇFARË TREGOJNË
TË DHËNAT? F.8**

SPORT



**KOSOVA U-21 MËSON
KUNDËRSHTARËT NË
KUALIFIKIMET PËR 'EURO 2027' F.8**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Senati miraton Pam Bondin, ditë të zeza për Jack Smithin dhe Gjykatën Speciale



Shkruan: Astrit GASHI

Me 54 vota për dhe 46 kundër, Senati Amerikan miratoi Pam Bondin, të nominuarën e Donald Trumpit për postin e Prokurorës së Përgjithshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në seancën dëgjimore përballë

Senatit, Pam Bondi deklaroi se synimi i saj kryesor do të ishte zhdukja e politizimit në Departamentin Amerikan të Drejtësisë, rikthimi i besimit dhe integritetit në këtë institucion dhe garantimi që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit.

Rishikimi i çështjeve të Jack Smith në ditën e parë të punës

Menjëherë pas marrjes së detyrës, Bondi ka nisur një rishikim të plotë të rasteve kundër Donald Trump, veçanërisht atyre që janë udhëhequr nga ish-prokurori

special Jack Smith. Ky i fundit kishte hetuar Trumpin për keqpërdorimin e dokumenteve të klasifikuara dhe për përpjekjet e tij për të përmbysur rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020.

Në ditën e saj të parë në detyrë, Bondi ka krijuar një grup pune të posaçëm për të shqyrtuar veprimet e Smith dhe prokurorëve të tjerë që kishin ndjekur penalisht Trumpin. Kjo lëvizje shihet si një ndryshim i madh në Departamentin e Drejtësisë, duke zhvendosur fokusin drejt politikave të administratës aktuale. Gjatë verës së kaluar, Bondi e ka quajtur Jack Smith - ish-



kryeprokurorin e Gjykatës Speciale - "një qen të tërbuar", duke theksuar kritikën e saj të ashpër për rolin dhe mënyrën se si ai ka drejtuar hetimet kundër Trumpit.

Me Pam Bondin në krye të

Departamentit Amerikan të Drejtësisë, Gjykata Speciale dhe hetimet ndaj Trumpit duket se do të hetohen menjëherë ku i pari do të jetë Jack Smith i cili ngriti aktakuzë kundër liderëve të UÇK-së.

Ukraina i pranon avionët e parë luftarakë francezë, Mirage 2000

KIEV, 6 SHKURT - Franca njoftoi të enjten se ia ka dorëzuar Ukrainës avionët e parë luftarakë, Mirage 2000, duke ia rritur mundësitë Kievit për ta mbrojtur hapësirën e vet ajrore nga bombardimet e pareshtura ruse. "Avionët e parë të këtij lloji kanë mbërritur sot në Ukrainë", tha ministri i Mbrojtjes i Francës, Sebastien Lecornu, në një shkrim në X të enjten.

Ai nuk tregoi se sa avionë luftarakë francezë u dërguan në Ukrainë. "Me pilotë ukrainas në bord, pasi ata u stërvitën për disa muaj në Francë, këta avionë do të ndihmojnë për ta mbrojtur qiellin mbi Ukrainë", shtoi ai.

Parisi pati njoftuar se do t'i dorëzonte Ukrainës avionë luftarakë, Mirage 2000, në fillim



të vitit 2025. Këta avionë janë të armatosur me raketa ajër-tokë dhe me masa kundër luftës elektronike.

Ukraina ka kërkuar prej kohësh avionë luftarakë modernë nga vendet e Perëndimit,

veçanërisht avionët F-16 dhe Mirage. Në vitin 2023 disa vende aleate u pajtuan t'i dhuronin Ukrainës avionë F-16 me pëlqimin e ShBA-së. Avionët e parë F-16 iu dorëzuan Kievit në gusht 2024. "Ky është një tjetër

hap drejt forcimit të sigurisë së Ukrainës", tha presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky për mbërritjen e avionëve.

"Me ardhjen e këtyre avionëve ne po vazhdojmë zgjerimin e flotës sonë të F16-shave, me Holandën që po i përmbush premtimet për ta mbështetur këtë përpjekje", shtoi ai.

Ukraina po bën përpjekje për t'i zbrapsur sulmet e pareshtura ajrore të Rusisë dhe ta frenojë përparimin e ushtrisë ruse në vijën e frontit, në prag të përvjetorit të tretë të luftës më 24 shkurt.

Në të njëjtën kohë, Kyevi ka ndërmarrë ofensiva aty ku ka mundur për ta forcuar pozicionin e tij, në një kohë kur Perëndimi po përpiqet t'i rinisë bisedimet për një armëpushim

dhe për një marrëveshje të mundshme paqeje.

Ndërkohë, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës tha të enjten se kreu sulm me dronë gjatë natës në bazën ajrore Primorsko-Ahtarsk në rajonin Krasnodar të Rusisë. Sipas zyrtarëve ushtarakë ukrainas, kjo bazë shërbente si pikë kyçe për ruajtjen, përgatitjen dhe lëshimin e dronëve Shahed, si dhe për mirëmbajtjen e avionëve që mbështesin operacionet ruse në rajonet Zaporizhja dhe Herson të Ukrainës.

Kanale ruse në Telegram dhe banorë të qytetit Primorsko-Ahtarsk raportuan për sulmin me dronë, ndërsa video të shpërndara në internet shfaqën zjarr pranë fushës ajrore.

Janari i këtij viti, më i nxehti në histori

BRUKSEL, 6 SHKURT - Muaji i kaluar ishte janari më i nxehtë në histori, tha monitoruesi evropian i klimës më 6 shkurt. Temperaturat e larta u regjistruan pavarësisht prej pritjeve se kushtet më të ftohta të fenomenit, La Nina, mund t'i ulnin temperaturat e larta në botë.

Shërbimi për ndryshime klimatike, Copernicus, tha se janari ishte 1.75 gradë celsius më i nxehtë sesa në kohërat paraindustriale, duke vazhduar këtu shënimin e temperaturave rekord që u regjistruan më 2023 dhe 2024, teksa emetimet e gazrave serrë po ngrohin planetin.

Shkencëtarët klimatikë kishin pritur që trendi i temperaturave të larta të ndalej, pasi fenomeni klimatik i të nxehtë, El Nino, arriti kulmin në janar të vitit 2024 dhe temperaturat gradualisht filluan

të ftohen pasi nisi faza e La Nina. Por, i nxehti ka vazhduar duke iu afruar rekordeve të reja, gjë që ka nxitur debat në mesin e shkencëtarëve lidhur me faktorët që po i çojnë temperaturat përtej pritjeve.

"Kjo është pak befasisëse... nuk po shohim efektin e ftohjes, apo ulje të përkohshme të temperaturave globale që kemi pritur që të shohim", tha për AFP-në, Julien Nicolas, shkencëtar klimatik në Copernicus.

Efekt i La Nina pritet të jetë i vogël dhe Copernicus tha se temperaturat mbizotëruese në pjesë të Oqeanit Paqësor sugjerojnë se "ka ngadalësim ose ngecje" të efekteve të fenomenit të ftohjes.

Shkencëtarët kanë paralajmëruar se çdo rritje e një fraksioni të një grade rrit intensitetin dhe frekuencën e ngjarjeve ekstreme



të motit, sikurse valët e të nxehtë, shirat e rrëmbyeshëm dhe thatësitë.

Muajin e kaluar Copernicus tha se temperaturat mesatare globale gjatë vitit 2023 dhe 2024 për herë të parë kaluan 1.5 gradë celsius. Sipas montuesit evropian, kjo nuk nënkupton tejkalim të

përhershëm të synimit të vendosur në Marrëveshjen për Klimën të Parisit që temperaturat të mos ngrohen më shumë se 1.5 gradë celsius.

Në përgjithësi, sipas Copernicus, viti 2025 nuk pritet të ketë temperatura sikurse dy në vitet paraprakë, por shkencëtarët

presin që të radhitet viti i tretë më i nxehtë në histori.

Kjo organizatë e klimës tha se do t'i monitorojë temperaturat në oqeanet përgjatë vitit 2025 për të parë nëse do të ketë ndryshime të tjera të temperaturës.

Monitoruesi i BE-së përdor miliarda matje nga satelitët, anijet, avionët dhe stacionet e motit për t'i bërë llogaritjet klimatike.

Ky monitorues ka nisur të mbledhë të dhëna për klimën që nga viti 1940, por burimet e tjera të dhënash për klimën - sikurse bërthamat e akullit, rrathët e pemëve dhe skeletet e koralit - u mundësojnë shkencëtarëve që t'i zgjerojnë konkluzionet e tyre duke përdorur të dhëna që datojnë shumë më herët.

Shkencëtarët thonë se periudha aktuale me gjasë është periudha më e nxehtë që Toka ka përjetuar në të paktën 125.000 vjet.

Raporti i OJQ-ve: Gjashtëmbëdhjetë kandidatë për deputetë me aktakuza aktive

Gjashtëmbëdhjetë kandidatë për deputetë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit kanë aktakuza aktive, u tha në një raport të organizatave joqeveritare të paraqitur të enjten. Sipas raportit të OJQ-ve, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Lëvizja FOL dhe INPO, nga 16 kandidatë, tre prej tyre kanë më shumë se një aktakuzë aktive. Numri i aktakuzave ndaj tyre arrin në 20, ndërkaq numri i veprave penale në 21. Me aktakuzë aktive, Lëvizja Vetëvendosje ka në listë tetë kandidatë, Koalicioni AAK-Nisma shtatë dhe LDK-ja një kandidat për deputet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHKURT - Gjashtëmbëdhjetë kandidatë për deputetë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit kanë aktakuza aktive, u tha në një raport të organizatave joqeveritare të paraqitur të enjten. Gjatë prezantimit të raportit “Integriteti i kandidatëve, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë”, u tha se në listat e tyre zgjedhore, Lëvizja Vetëvendosje, koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - Nisma dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, kanë kandidatë që kanë probleme

me ligjin.

Sipas Burbuqe Kastratit, hulumtuese në Lëvizjen FOL, këto parti së bashku kanë 23 persona që kanë probleme me ligjin. Kjo, sipas saj, nënkupton se ka kandidatë që kanë akuza aktive ose që në të kaluarën janë dënuar për vepra penale të ndryshme.

Sipas raportit të OJQ-ve, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Lëvizja FOL dhe INPO, nga 16 kandidatë, tre prej tyre kanë më shumë se një aktakuzë aktive. Numri i aktakuzave ndaj tyre arrin në 20, ndërkaq numri i veprave penale në 21. Me aktakuzë aktive Lëvizja Vetëvendosje ka në listë tetë kandidatë, Koalicioni AAK-

Nisma shtatë dhe LDK-ja një kandidat për deputet, u tha në raportin e OJQ-ve.

Kastrati tha se ka aktakuza të natyrës korruptive, sikurse keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar. Por, ka edhe aktakuza për armëmbajtje pa leje, pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare dhe sulm ndaj personit zyrtar. Raporti përfshin edhe të dhëna sa iu përket dënimeve për vepra penale të kandidatëve për zgjedhjet e 9 shkurtit. Tetë kandidatë janë dënuar në të kaluarën për vepra të

ndryshme penale.

Por, atyre nuk iu pamundësohet gara në zgjedhjet e 9 shkurtit pasi, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, një person që është i dënuar në formë të prerë në tre vjetët e fundit për një vepër penale me një ose më shumë vjet burgim, nuk mund të kandidojë në zgjedhje. Edhe në zgjedhjet e mëparshme në listat zgjedhore ka pasur kandidatë me probleme me ligjin. Atëbotë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk kishte certifikuar 47 prej tyre për shkak se ata ishin shpallur

fajtorë në tre vjetët e fundit, teksa në listën përfundimtare zgjedhore kishin kandiduar 15 persona që kishin probleme me ligjin.

Në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 garojnë 28 subjekte politike dhe një kandidat i pavarur. Në listat zgjedhore gjithsej janë 1 280 kandidatë për përbërjen e re parlamentare. Këto do të jenë zgjedhjet e para të rregullta që Kosova mban që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Deri më tani në vend janë mbajtur një sërë zgjedhjesh të parakohshme.

DnV: Ngjyra matrikuluese e blerë për zgjedhje nuk i plotëson standardet



PRISHTINË, 6 SHKURT - Rrjeti i organizatave joqeveritare në Kosovë, Demokracia në Veprim (DnV), ka shprehur shqetësim për integritetin e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, pasi ka thënë se ngjyra matrikuluese që do të përdoret për ta shenjëzuar gishtin e votuesit “nuk i përmbush standardet e kërkuara”. Sipas DnV-së, që është thirrur në burime brenda Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ngjyra matrikuluese do të duhej të qëndronte në gisht të votuesit për të paktën 48 orë - gjë që thonë se s’ndodh me ngjyrën që do të përdoret në zgjedhje. “Ngjyra matrikuluese që është pranuar javën e kaluar përmes procedurave tenderuese nuk i ka përmbushur standardet e kërkuara. Sipas këtyre informatave, shenja e

matrikulimit po qëndron në gisht pak kohë dhe e njëjta mund të fshihet lehtësisht”, thuhet në reagimin e DnV-së në “Facebook”. “Kjo do të mund ta cenonte seriozisht integritetin e procesit zgjedhor”, paralajmëron DnV-ja. “Radio Evropa e Lirë” ka kontaktuar KQZ-në lidhur me këto pretendime, por nuk ka marrë përgjigje deri tani.

Përdorimi i ngjyrës matrikuluese ka nxitur kundërshtime edhe më parë, pasi që grupe të shoqërisë civile i kishin thënë “Radios Evropa e Lirë” se janë të shqetësuar se kjo praktikë mund t’i ekspozojë publikisht votuesit, duke çuar potencialisht në stigmatizimin e tyre. Me rregulloren e miratuar më 21 qershor të vitit 2024, KQZ-ja kishte vendosur që për herë të

parë në zgjedhjet e reja të përdoret kjo ngjyrë. Në zgjedhjet e mëparshme është përdorur sprej i padukshëm, i cili ka mundur të verifikohet vetëm me dritë ultravjollcë. Në Kosovë e drejta për të votuar është private. Zgjedhjet në Kosovë do të mbahen të dielën, më 9 shkurt. Të drejtë vote në këto zgjedhje parlamentare kanë mbi dy milionë persona.



Rreziku nga objektet e vjetra: Kush është përgjegjës për parandalim dhe reagim?

Prishtinë, 6 shkurt - Shembja e një objekti të vjetër në fshatin Jabllanicë të Gjakovës, më 1 shkurt, ku humbën jetën tre të mitur, është duke u hetuar nga Prokuroria, e cila rastin e ka iniciuar si “Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”. Por, kjo Prokurori ende nuk ka bërë me dije se kush saktësisht po hetohet apo dyshohet të jetë shkaktar apo fajtor në lidhje me incidentin.

Sipas komunës së Gjakovës, ky objekt i braktisur ishte ndërtuar para vitit 1999 dhe ishte djegur rreth atij viti, duke lënë pas një strukturë të dobët, e cila u shemb në rrethana të panjohura duke zënë brenda fëmijët - dy 15 dhe një 13-vjeçar. “Duke qenë në pronësi private, komuna nuk ka kompetenca të ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me objektin”, i tha “Radios Evropa e Lirë”, zëdhënësi i komunës, Artan Haraqija. Ai shtoi se lidhur me këtë objekt nuk kanë pasur ndonjë ankesë apo kërkesë për rrënimin apo sigurimin e tij, qoftë nga pronari apo banorët afër.

Haraqija shtoi se “në raste të caktuara kur vetë inspektorët [komunalë] mund të vërejnë ndonjë objekt që paraqet rrezik, atëherë kontaktohet pronari dhe i shpjegohen mundësitë dhe procedurat për rrënimin e objektit”. Megjithatë, sipas tij, deri më tani nuk kanë pasur “ndonjë rast ekstrem kur paraprakisht është vlerësuar shkallë e lartë e rrezikshmërisë”. Komuna, po ashtu, nuk ka bërë

me dije nëse ka përpiluar ose do të përpilojë ndonjë dokument që identifikon objektet private apo publike me rrezikshmëri për shembje në këtë zonë. “Në total nuk mund të flasim për numër të madh të objekteve të tilla, veçanërisht në zonë urbane dhe në zona të banuara nëpër fshatra”, tha Haraqija.

Çfarë thonë ligjet?

Komuna apo organet komunale konsiderohen ndër organet e para përgjegjëse për reagim dhe parandalim në disa raste të fatkeqësive natyrore, ku përfshihen edhe rreziqet nga shembja. Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për Parandalimin e Fatkeqësive Natyrore dhe në veçanti të Planin e Reagimit Kombëtar të miratuar në fund të vitit 2023. Ky plan i përpiluar nga qeveria thotë se me incidentet, në përgjithësi, duhet të përballen niveli më i ulët i mundshëm administrativ sikurse policia, zjarrfikësit... dhe personeli tjetër në nivelin lokal. Sipas këtij plani, kur një incident aktual ose i mundshëm ka përmasa dhe kompleksitet të tillë sa që konsiderohet si “incident me karakter kombëtar”, përgjegjësia bie edhe mbi nivelin qendror, përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila vepron në koordinim me ministrinë dhe agjencitë e tjera qeveritare. Në veçanti, plani parashihet që kryetari i komunës është përgjegjës për koordinimin e

resurseve komunale në funksion të “adresimit të të gjithë spektrit të veprimeve për parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje nga incidentet, përfshirë fatkeqësitë natyrore dhe ato të tjera”.

Kryeqyteti me 61 shtëpi në rrezik shembjeje

Rreth 90 kilometra larg Gjakovës, edhe kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, po ashtu përballlet me rreziqe nga objektet e vjetra.

Lulzim Fushtica, drejtor i Emergjencave në këtë komunë, i tha “Radios Evropa e Lirë” se rreth një muaj më parë kishin bërë identifikimin e rreth 61 shtëpive, disa mureve si dhe një lokali, që rrezikojnë të shemben. Ai tha se komuna i bën këto vlerësime çdo gjashtë muaj dhe kryen inspektime dhe intervenime sipas nevojës nëpër objekte të ndryshme. Fushtica tha se këto veprime i kryejnë duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore, ndonëse nuk ekziston ndonjë direktivë tjetër e veçantë që udhëzon komunat se si të veprojnë në këtë drejtim. Duke folur për “REL”-in, Fushtica shpjegoi se zakonisht kanë të bëjnë me tri kategori objektesh në rrezik që përfshijnë objekte private, ato të cilat kanë nisur të ndërtohen dhe kanë mbetur në gjysmë, si dhe objekte të vjetra që konsiderohen trashëgimi kulturore dhe janë nën mbrojtje

nga qeveria qendrore. Sipas tij, tek objektet në pronësi private, komuna e ka të vështirë të intervenojë. “Në një pjesë të madhe të tyre pronarët nuk janë fare në Kosovë dhe i kanë lënë objektet pa përkujdesje dhe ne, në bazë të ligjit, nuk mund të intervenojmë në pronë private sepse rrezikojmë të paditemi”, theksoi ai.

Ai shtoi se zakonisht mundohen që të kontaktojnë me pronarët për t’u koordinuar për sigurimin e objektit apo edhe rrënimin e tyre, nëse ka nevojë për intervenim nga komuna. Për kategoritë e tjera, komuna tha se intervenon apo koordinohet me institucionet përkatëse për intervenim sipas nevojës. Ai theksoi se rasti i Jabllanicës ka bërë që qytetarët t’i shtojnë thirrjet në drejtim të komunës për t’i paraqitur objektet që përbëjnë rrezik.

Përveç Prishtinës, identifikimin e objekteve me rrezikshmëri e ka bërë edhe komuna e Deçanit. Në një plan të përpiluar në gusht të vitit 2024, Deçani kishte identifikuar 12 objekte të vjetra që rrezikojnë të shemben, duke përfshirë disa kulla (shtëpi tradicionale të vjetra banimi, kryesisht të ndërtuara me gurë).

Në këtë plan komuna ka listuar disa masa preventive që duhen ndërmarrë karshi këtyre objekteve, që përfshijnë shenjëzimin e deri te rrënimin. Deri më tani, kjo komunë nuk u është përgjigjur pyetjeve se çfarë veprimesh janë ndërmarrë karshi këtyre

objekteve. Përveç objekteve private, në Kosovë ka pasur raste kur janë shembur edhe objekte nën mbrojtje shtetërore që kanë qenë vdekjeprurëse.

Një vajzë trevjeçare nga Prizreni humbi jetën në vitin 2016 si pasojë e shembjes së një shtëpie që gjendej në zonën e mbrojtur historike të këtij qyteti.

Në lidhje me këtë rast ishte ngritur aktakuzë ndaj drejtorit komunal për emergjencë dhe siguri, por gjykata e Prizrenit e liroi nga akuza në vitin 2019.

Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave nuk u është përgjigjur pyetjeve të “REL”-it në lidhje me atë se a ekziston ndonjë plan në nivel kombëtar që adreson rreziqet nga shembja e objekteve.

Ndërkaq, në fshatin Jabllanicë të Gjakovës, rrethanat e sakta të shembjes së objektit nuk dihen. Familjarët e viktimave, por edhe banorët e tjerë të fshatit, nëpër deklaratime publike kanë thënë se nuk kanë pasur indikacione se objekti përbënte rrezik aq të madh për shembje sa që të ngrinin alarm tek institucionet. “Askush në fshat nuk ka folur për të. Ka qenë i rrethuar me tela. Ka qenë në rrugë anësore, por nuk ka pasur shumë lëvizje përreth tij”, i tha “Radios Evropa e Lirë”, Bajrush Brahimaj, banor i Jabllanicës, më 3 shkurt 2025, ditën kur në fshat u mbajt ceremonia e varrimit për të miturit që humbën jetën nga shembja e objektit të vjetër.

Kosovë, (pa)barazia gjinore në programet dhe fushatën zgjedhore

Prishtinë, 6 shkurt - Derisa partitë politike pohojnë në fushatën për zgjedhjet e së dielës se do të investojnë në përmirësimin e gjendjes së grave në Kosovë, veprimtare të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të grave vendosën në ndërtesën e parlamentit një mbishkrim “Politika për barazi - jo paga për riprodhim”. Ato thanë se në programet e partive politike çështjet që ndërlidhen me gratë i përqendrojnë kryesisht në aspekte të riprodhimit. “Një parti premton 500 euro, një tjetër 5 mijë, të tjerat paga e shtesa për lehonat, por jo si mbështetje për gratë. Por si një mekanizëm për t’i mbajtur ato të ngujuara në role të kujdesit. Për t’i shtyrë drejt lindjeve në emër të sigurisë së kombit dhe rritjen e natalitetit. E gjithë kjo është një strategji për ta forcuar kontrollin mbi trupin e gruas, për ta bërë prodhimin një detyrë dhe jo një zgjidhje, jemi këtu për ta shpallur rezistencën tonë”, tha Eleta Shala nga Rrjeti i Grave të Kosovës.

Partitë politike kanë përmbushur detyrimin nga Ligji për Zgjedhjet që 30 për qind e kandidatëve për zgjedhjet e 9 shkurtit të jenë gra, që për veprimtarët humanitarë është e pamjaftueshme, meqë Ligji për Barazinë Gjinore në vend parasheh që përfaqësimi të jetë 50 për qind. Në tubime partitë janë përqendruar në aspektet ekonomiko-sociale kur bëhet fjalë për gratë. “Secilës grua do t’ia japim për gjashtë muaj, në ndërmarrje private ku punësohet, pagën minimale si bonus. Gjysheve e gjyshërve që do të kujdesen për fëmijët prej moshës 1 deri në 3 vjeç, kur të dy prindërit janë në punë, do t’ua japim një shtesë mujore 100 euro”, tha kryeministri i Kosovës,



Albin Kurti, gjatë një tubimi të Lëvizjes Vetëvendosje. Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës për kryeministër, Bedri Hamza, gjatë një tubimi ka folur për ofertën e tij. “Për nënat e reja, për prindërit e rinj, 100 euro subvencion për çdo fëmijë që shkon në kopshte private, për më shumë - përkrahje nëpërmjet subvencioneve dhe granteve për lehtësim në qasjen në financa”, tha Hamza. Ndërkaq kandidati për kryeministër i Lidhjes Demokratike, Lumir Abdixhiku, ka thënë se për çdo të porsalindur në Kosovë për vitin e parë të lindjes të gjitha shpenzimet do t’i mbulojë qeveria nën drejtimin e tij. “Ta kenë shëndetin e jetën, për

gjërat e tjera kujdeset shteti i Kosovës”, tha Abdixhiku gjatë një tubimi elektorale. Eleta Shala nga Rrjeti i Grave të Kosovës ka theksuar se nuk do të lejojnë që të drejtat e tyre riprodhuese të shkëmben për agjenda populiste e nacionaliste. “Ne refuzojmë politikën konservatore që në maskën e premtimeve financiare janë në fakt një sulm frontal ndaj autonomisë sonë trupore. Nuk do ta pranojmë asnjë fushatë që kërkon ta rrisë lindshmërinë në këmbim të lirisë sonë. Nuk do të lejojmë që të drejtat tona riprodhuese të shkëmben për agjenda populiste e nacionaliste”, tha Shala. Valmira Rashiti, hulumtuese e politikave gjinore, i tha “Zërit të Amerikës” se trajtimi i

barazisë gjinore nga partitë politike në Kosovë është sipërfaqësor dhe nuk përkon me nevojat e vendit. “Fakti që as në programet e tyre nuk e kanë parë të denjë të targetojnë dhunën në familje, nivelin e ulët të punësimit të grave, diskriminimin në punësim, ngacmimet seksuale që ndodhin edhe në treg të punës, kjo ka qenë tepër shqetësuese për ne. Rrjedhimisht jemi pesimiste mbi atë se çfarë do të bëjë një qeveri në ardhje kur në programe nuk e ka reflektuar zotimin për barazi gjinore”, thotë ajo. Në një analizë të publikuar së fundmi nga Qendra e Kosovës për Studime Gjinore thuhet se barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë integruar qartë

në programet e partive politike. Sipas kësaj analize, “Lidhja Demokratike e Kosovës përmend barazinë gjinore vetëm katër herë në programin e saj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës që garon me Nismën dhe partnerët, vetëm njëherë përmend ‘barazinë dhe drejtësinë gjinore’, ndërsa Partia Demokratike dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk e përmendin fare këtë çështje në programet e tyre”. Me mesatarisht mbi dy mijë e 500 raste në vit, dhuna në familje mbetet ndër shqetësimet kryesore për gratë në Kosovë, pasuar nga sfida të tjera si pabarazia ekonomike apo shkalla e ulët e përfaqësimit në jetën publike.

Media evropiane: Bedri Hamza mund të sjellë qasje të re në qeverisje



PRISHTINË, 6 SHKURT - Mediumi “EU Today” ka botuar një analizë të zgjedhjeve në Kosovë, duke bërë një sërë parashikimesh rreth mundësisë së ndryshimit të qeverisjes në Kosovë. Sipas këtij portali, “marrëdhënia e Kurtit me ShBA-në dhe BE-në është përkeqësuar në vitet e fundit dhe ka ardhur koha për një qasje të re. Britania mund të ofrojë mbështetje për një qeveri të re”. “EU Today”, po ashtu, vlerëson se “zgjedhjet e 9 shkurtit mund të sjellin një qeveri të re, me shumë gjasa të udhëhequr nga Bedri Hamza, kryetari aktual i

Mitrovicës Jugore dhe ish-ministër i Financave”. Më tutje, “EU Today” përshkruan profilin e kandidatit të PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, duke e quajtur “një figurë e qetë, e fokusuar tek ekonomia, shëndetësia dhe arsimit; pikat kyçe që i duhen gjithë rajonit për të ecur përpara”. Sipas këtij mediumi, “nëse Hamza bëhet lideri i ri i Kosovës, kjo do të mirëpritet nga Uashingtoni, kryeqytetet e BE-së dhe do të përbënte një mundësi për qeverinë laburiste britanike që të përfitonte nga një investim

strategjik në politikën e jashtme”. Autori, po ashtu, thërret që Britania të luajë rol më aktiv në Ballkan: “David Lammy në rolin e tij si sekretar i jashtëm në hije bëri një vizitë të hershme në Kosovë. E pyetja që shtrohet është se nëse ai mund ta kthejë këtë shprehje interesi në një angazhim serioz britanik për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të rajonit ose të paktën për t’i ulur tensionet? Kjo do të ishte një mundësi për të treguar se Britania po rikthehet si një fuqi kyçe evropiane, pa pritur një rikthim të mundshëm në BE”.

Kamerat e sigurisë për zgjedhje në Kosovë nga Serbia



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Cfarë poshtërsie: KQZ-ja, ndonëse u kundërshtua, vendosi që vendimet të mbikëqyren nga kamera të sigurisë duke ndarë mjete të konsiderueshme për këtë. Dhe këto kamera u sollën në Kosovë në mbrëmjen e vonshme të 3 shkurtit duke u zbrazur në Ministrinë e Drejtësisë. Për opinionin duket lajm i pabesueshëm se nga cili vend u sollën kamerat e sigurisë aq më parë që partia multietnike LVV që është në pushtet dhe regjimi i Albin Kurtit erdhën në pushtet me sloganin: “duaje tëndën” dhe me mendermethënë bojkotimin e mallrave të Serbisë! Kamioni ishte me targa serbe, me shofer nga Serbia i cili pranoi se këto janë kamera të sigurisë dhe të cilat u zbrazën në Ministrinë e Drejtësisë apo bastionin kundër UÇK-së dhe çlirimtarëve që po mbahen si pengje në Hagë. Nga kjo ministri janë ndërmarrë masat shtrënguese dhe kufizuese që përmbajtësisht kanë pakësuar mundësinë e sigurimit të një mbrojtjeje efektive për të burgosurit e Hagës duke ua pakësuar fondet dhe sipas disa dyshimeve edhe duke siguruar dëshmitarë të mbrojtur. Kjo ministri kurrë nuk ka reaguar kundër shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut ndaj pengjeve të Hagës që e ka detyrim ligjor për të gjithë shtetasit e Kosovës. Asnjëherë nuk ka sqaruar takimet sekrete që mbaheshin në terr informativ nga lakuriket e natës, Trandafilovkës, si kryetare e Gjykatës Raciste Speciale dhe Lenka Çukos, ish ministre e Drejtësisë. As tash përkundër lajmit në media, Ministria e Drejtësisë nuk e demantoi këtë lajm apo nuk dha sqarim për qytetarët e Kosovës si ndodhi që kamioni nga Serbia të sjellë kamera të sigurisë në Kosovë për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Mos

u rikthyen në lojë përsëri lidhjet midis zemlakëve, Radoiqiçit dhe Mimoza Kusarit që u treguan si biznesmenë të suksesshëm kundër veteranëve të luftës dhe UÇK-së?! A mos është edhe një tender që e ka ndarë grupi Me Kryeministrin përmes Whats App-it përmes Dejana Mihalit, tash me dikend nga KQZ-ja?! Të poshtër njëherë, të poshtër gjithëherë! Patriotë multietnikë, dhunues të parardhësve patriotë! Turpërues të trashëgimisë kombëtare dhe sakrifikuese të paraardhësve që me këto sjellje antikombëtare po ua lëvizin eshtrat në varr.

Fushata drejt fundit: Çdo gjë e ka një fillim dhe një përfundim sikur edhe fushata e partive politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Dikush po rrenë, dikush po mashtron, dikush po tradhton dhe të gjithë po premtojnë, çka bëhet dhe çka nuk bëhet. Asnjëherë partitë politike nuk kanë qenë më aktive, më lëvizëse dhe më afër qytetarit - votuesit. Kanë futur shumë para në fushatë, figura ndërkombëtare madje edhe kurdisje përmes Inteligjencës artificiale. Përveç Walkerit, edhe Grenelli u “regjistrua” për votim përkatësisht për formim të qeverisë së ardhshme. Në këtë kontekst po blihen takimet me senatorë, kongresmenë, me udhëheqës të partive të djathta (janë në mirë) dhe partive të majta me shpresë se do të kthehen në modë. Mendoj se votuesit janë përcaktuar për partinë që do ta votojnë, mbesin disa paqartësi të vogla deri në fund. Të besosh se do të fitosh vota apo se kundërshtari do të humbë vota pas deklaratës ndërhyrëse të emisarit Richard Grenell është njëjtë sikur të mos blesh mish duke shpresuar të koçet e dashit. Po nuk e keni të

ndaluar të besoni, si partia multietnike LVV-ja ashtu edhe opozita. Gjatë fushatës pozita përdori fjalor rruge kurse pozita duroi me stoicizëm dhe dinjitet rrugatë e rrugës - fushatës që për mua është vlerë e shtuar në fazën e parademokracisë që aktualisht është në Kosovë. Me saktësi qind për qind kam paraparë fitoren e Trampit dhe republikanëve dhe kjo nuk ka ndikuar aspak gjatë parashikimit për zgjedhjet e ardhshme në Kosovë. Qëndroj pranë asaj që e kam shkruar pata gjashtë muajve se: LVV-ja fiton midis 28 - 33 për qind, PDK-ja fiton 23 - 26 për qind, LDK-ja fiton 22 - 25 për qind, AAK-ja 9 - 12 për qind dhe Koalicioni për Familjen 4 - 5.5 për qind. Me siguri të madhe e them se nëse nuk ndodhë ndonjë përmbajtje apo tradhti e madhe, Albin Kurti nuk do të jetë KM i Kosovës e as LVV-së në qeverinë e ardhshme. Regjimi totalitar i Albin Kurtit do të zëvendësohet nga opozita.

Koalicionet e mundshme: Për kah gjaku politik, LVV-ja është më e afërta me LDK-në mirëpo nëse bëhet ky koalicion, LDK-ja do të bluhej nga LVV-ja ku, tradhtia e Vjosa Osmanit e vitit 2021 do të konsiderohej vepër humane. Nëse PDK-ja do të bënte koalicion me LVV-në për mua do të ishte një tradhti njerëzore, morale, politike dhe dhumim i sakrificës së dëshmorëve të Kombit dhe të luftës Çlirimtare të lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Po, ta shohim, në Kosovë asgjë nuk është e pamundur të ndodhë prandaj edhe jemi rast sui generis.

A është kijameti afër: Librat fetarë thonë se mbrojtja më e fuqishme ndaj fundit të botës - njerëzimit janë femijët, budallenjtë dhe hajvanati -

kafshët. Deri vonë Kosova dhe shqiptarët kishin siguri të 100 për qind nga kijameti sepse i kishim të fuqishme dhe të qëndrueshme tri shtyllat kundër fundit të botës. Së fundi ka pasur zhvillime dramatike, ka rënë nataliteti në Kosovë, në vend të rritjes së fondit të shtazëve po blejmë mish dhe pula nga Brazili dhe optimizmin e vetëm për mbijetesë të botës pjesë e së cilës kam edhe unë, janë numri i madh i budallenjve, që kemi aq shumë sa që mund ta shpëtojmë edhe pjesën tjetër të botës. Zoti i Madhërishtëm nuk t'i japë të gjitha por as nuk t'i merr të gjitha!

Prokuroria Speciale e Albin M. Babës dhe Lenka Sh. Çukos: Albini nuk e do Prokurorinë aktuale por dëshiron një Prokurori me kryeprokurore Dejana Mihali - Micotakis. E do një Prokurori e cila Martin Berishën do ta shpallte simbol nderi dhe simbol kundër korrupsionit. Një Prokurori që e donë dhe e çmon Ridin dhe Gopin, e përqafton Rozin dhe Jetën, Besnik Rrenc Bislmin, hajdutët e ujit, hajdutët e asfaltit, hajdutët e ilaçeve dhe hajdutët e shpresës. Albin M. Baba do që krejt hajnat e përbashkuar rreth tij të mbrohen nga Prokuroria Speciale që do ta formonte me Lenka Sh. Çukon dhe, po kjo Prokurori të ndjekë të gjithë ata që e mohojnë atësinë e Albin M. Babës. Shpreson magari se në Saharë do të rritet bari! As Jezu Krishti nuk i ka mbrojtur apostujt e vet sa Albin M. Baba i mbronë hajnat e vet!

Lajme të pa - besueshme: Erdhi dita që HAJNnullah Çeku ta akuzojë dikend për korrupsion. Njëri ndër kryehajnat e regjimit Kurti po e akuzon Përparim Tamën - Përrpën për korrupsion sigurisht në Prokurorinë

Speciale të Albin M. Babës dhe Lenka Sh. Çukos. Simptomë e kijametit të mundshëm. Liberalizimi i vizave ka pritur kohën kur Donika Shvarc do të bëhet ministre e Kurtit e jo se Kosova i ka plotësuar kushtet. Qeveria Kurti është qeveria e vetme në botë që ka plotësuar premtimet 200 përqind. Lajm i shpërndarë nga Shtimja, nga Donika Shvarc gjatë kafes “Me Çlirimtarin”. Më 9 shkurt 2025 votohet referendumi kundër korrupsionit, nepotizmit, kapjes së institucioneve dhe ndërmarrjeve publike tha KM Kurti. Këtë top lajm përsërite me 1 prill, 9 shkurti nuk është datë e përshtatshme. Kemi aplikuar për anëtarësim në Këshill të Evropës, jemi vetëm një hap larg, rrenë e Donika Shvarc Zezës. As nuk u pranuan ndonëse ne Kurtin e nënshkruan fletën poseduese të pronës që nuk i takon Manastirit të Deçanit. Na mashtruan neve, por dështuan me Evropën. Kurti ndau 500.000 euro për Gazën por nuk ndau asnjë zemër për viktimat e gjenocidit në Gazë. Nuk pati b...ë e k.e. Padinë për gjenocid kundër Serbisë, Albin M. Kurti dhe Lenka Sh. Çuko do ta bëjnë me Palestinën për gjenocidin në Gazë! U harrua raporti hetues për shpërthim në sistemin e kanalit Ibër - Lepenc në Varragë. A thua pse? Kaçketa humbi si “shurra e pulës”. A thua pse? Dhe, pse Vojsa Osmani shkoi pa paralajmërim në Deoattamentin e Shtetit Amerikan? Me i ra në gjunjë Grenellit për Albin Kurtin apo me ia premtua kokën e Albin Kurtit Grenellit! Për ta ruajtur kokën presidenciale, duke e shpëtuar Albinin apo duke e bërë Albinin Albin Pashë Tepelenë, kokën në Amerikë, trupin në Prishtinë!

Kontingjenti i FSK-së e përfundon me sukses ushtrimin ndërkombëtar “Winter EX 2025” në Turqi

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ushtrimi ndërkombëtar “Winter EX 2025”, i organizuar nga Komanda e Forcave Tokësore të Turqisë, ka përfunduar me sukses. Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka treguar aftësi të larta dhe profesionalizëm në zhvillimin e operacioneve në kushte të vështira dimërore. Gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e FSK-së bashkëvepruan me partnerët ndërkombëtarë në skenarë të ndryshëm operativë, duke dëshmuar përgatitjen dhe kapacitetet e tyre ushtarake. Komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së (KOMFT), gjeneralbrigade Hysen

Dreshaj, dhe komandanti i Regjimentit të Dytë të Këmbësorisë, nënkolonel Jaser Mulla, vizituan kontingjentin e FSK-së, ata u njohën nga afër me mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe operacioneve të realizuara. Me këtë rast, gjeneral Dreshaj përgëzoi pjesëtarët e kontingjentit për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar, duke theksuar rolin e tyre të rëndësishëm në përfaqësimin e FSK-së dhe shtetit të Kosovës në këtë ushtrim prestigjioz. Në vijim të aktiviteteve zyrtare, KOMFT, gjeneral Dreshaj, mori pjesë në darkën zyrtare të organizuar nga Komandanti i Forcave Tokësore të Turqisë, gjeneral Selçuk Bayraktaroglu,

ku ishin të pranishëm përfaqësues të të gjitha shteteve pjesëmarrëse, gjithashtu ndoqën nga afër Demonstrimin për Ditën e Vizitorëve të Shquar (DVD) ku u realizuan operacioneve të planifikuara nga shtetet pjesëmarrëse, përfshirë edhe kontributin e kontingjentit të FSK-së në këtë ushtrim ndërkombëtar. Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdon ta dëshmojë përgatitjen, disiplinën dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë në misione të ndryshme, duke rritur kapacitetet dhe përvojën operacionale të saj.



Shkeljet gjatë fushatës zgjedhore, PZAP-i gjobit me mijëra euro PDK-në, AAK-në dhe Koalicionin Vakut



PRISHTINË, 6 SHKURT - Që nga fillimi i fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, është vërejtur gjuhë nxitëse dhe e urrejtjes mbi baza politike në tubime dhe në komente në platforma online. Kështu të paktën ka vlerësuar rrejtja e organizatave joqeveritare, Demokracia në Veprim. Si rrjedhojë e kësaj klime të krijuar, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja (PZAP) ka shqiptuar mijëra euro dënime për subjektet politike që kanë shkelur Kodin e Mirësjelljes, raporton Telegrafi. Një ditë më parë PZAP-i ka

publikuar gjobat e radhës që ka shqiptuar ndaj subjekteve politike. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) është dënuar me 2 mijë euro gjobë pas ankesës së parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje lidhur me vendosjen e flamurit të AAK-së në oborrin e shkollës “Emin Duraku” në Shtime. LV ka dorëzuar edhe katër ankesa ndaj Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), e cila është dënuar nga PZAP me 16 mijë euro. Lëvizja Vetëvendosje më 3 shkurt kishte dorëzuar ankesat

në PZAP lidhur me disa postime të bëra në rrjetet sociale nga disa mbështetës të PDK-së ku është përdorur gjuhë ofenduese dhe urrejtëse. Dënimet nga PZAP nuk i ka shpëtuar as Koalicioni Vakut i cili është dënua me 1 500 euro, pas ankesës së dorëzuar nga Socialdemokratkan Unija (SDU). Sipas vendimit të PZAP-së, subjektet politike të cilat janë gjobitur, obligohen që dënimin ta paguajnë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

AIP u bënë thirrje partive politike t'i mbrojnë të dhënat personale të qytetarëve



PRISHTINË, 6 SHKURT - Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) përmes një njoftimi për medie ka përsëritur kërkesën për partitë politike për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve në komunikimet nëpërmjet postës elektronike (e-mail), mesazhet (SMS) dhe thirrjeve telefonike, pa pëlqim paraprak. Një njoftim thuhet se Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP),

në përmbushje të mandatit të saj ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përsërit kërkesën drejtuar partive politike në Kosovë për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 9 shkurt 2025. “Për të siguruar zbatimin e ligjit, Agjencia kërkon nga Partitë Politike zbatimin e detyrimeve

ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve duke mos përdorur dhe ekspozuar të dhënat personale në komunikimet nëpërmjet postës elektronike (e-mail), mesazhet (SMS) dhe thirrjeve telefonike, pa pëlqim paraprak”, thuhet në njoftim. Më tutje, AIP ofron bashkëpunim me të gjitha subjektet politike për të siguruar

respektimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe bën thirrje që çdo informacion personal i mbledhur gjatë procesit të regjistrimit të votuesve, për realizimin e komunikimit me qytetarët gjatë aktiviteteve të fushatës zgjedhore, të përdoret në përputhje me kërkesat ligjore.

Opozita në Gjilan sërish bojkoton seancën për votimin e buxhetit, mbi 2 000 punëtorë mbesin pa paga

GJILAN, 6 SHKURT - Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se sërish opozita i braktisi qytetarët e Gjilanit duke bojkotuar pjesëmarrjen në seancën urgjente të Kuvendit

Komunal për miratimin e buxhetit për vitin 2025. Mosmiratimi i buxhetit do të lë pa paga e në pasiguri totale 2 419 punëtorë komunalë. “Edhe sot në seancën urgjente të

Kuvendit Komunal opozita e ka injoruar thirrjen tonë duke e quar kështu komunën e Gjilanit drejt një gjendje emergjente që i lë qindra familje pa paga, e gjithashtu stopon të gjitha

investimet kapitale. Ne do të vazhdojmë të thërrasim seanca urgjente, duke shpresuar në reflektimin e shpejtë të opozitës”, ka shkruar Hyseni në “Facebook”.



Shpenzimi i parave publike në Kosovë: Çfarë tregojnë të dhënat?

PRISHTINË, 6 SHKURT - Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, buxheti vjetor i vendit ka ndjekur trendin konstant të rritjes. Ndër vite, qeveritë e ndryshme kanë pasur prioritete të ndryshme gjatë menaxhimit të buxhetit vjetor. Kur Qeveria e Kosovës ka marrë për herë të parë përgjegjësinë e menaxhimit të buxhetit vjetor nga Misioni i Kombeve të Bashkuara - UNMIK, në vitin 2008, buxheti ka qenë pak mbi një miliard euro. Që nga ajo kohë buxheti është më shumë se i dyfishuar. Nga 1.4 në 3.6 miliard euro, buxheti i Kosovës ka shënuar rritje të vazhdueshme në dhjetë vjetët e fundit. Me ndryshimin e qeverive ndarja e buxhetit nëpër ministri të ndryshme ka nxjerrë në pah edhe ku janë fokusuar ato qeveri. Por, ndryshimi i shpeshtë i tyre ka bërë që edhe fokusi të ndryshonte shpesh. Të dhënat tregojnë se më parë një pjesë e madhe e buxhetit është shpenzuar për infrastrukturë dhe planifikim hapësinor, por ky buxhet tani është më i vogël seç ka qenë në vitin 2010. Për shëndetësi, ndërsa, buxheti ka mbetur pothuajse i

njëjtë ndër vite, pavarësisht prej rritjes së buxhetit të përgjithshëm. Qeveria aktuale - e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje - është qeveria e parë që arrin ta përfundojë mandatin e plotë katërvjeçar. Që nga viti 2015 buxhetin e kanë udhëhequr Isa Mustafa i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Albin Kurti i Vetëvendosjes në qeverisjen e parë më 2020, para se të zëvendësohej pastaj nga Avdullah Hoti i LDK-së për më pak se një vit. Por, përderisa buxheti tregon planin e qeverisë për ndarjen e parave publike, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tregon edhe shpenzimet që qeveria ka bërë përmes raporteve që publikohen çdo tre muaj. Gjatë viteve të fundit më së shumti para janë shpenzuar për mbrojtje sociale, duke e zëvendësuar kështu prioritetin e mëparshëm për çështje ekonomike. Në vitet 2017-2018 Qeveria e Kosovës shpenzonte pjesën më të madhe të parave publike për çështje ekonomike. Së fundi, kjo



kategori ka zënë vendin e katërt, pas mbrojtjes sociale, shërbimeve të përgjithshme dhe arsimit. Në disa kategori, si ajo e mbrojtjes së mjedisit, buxheti nuk ka pësuar ndryshime drastike sa në disa të tjera. Mbrojtja e ambientit ka mbetur gjatë gjithë dekadës si kategoria për të cilën është shpenzuar përqindja më e vogël e parave publike, pavarësisht se kush ka qenë në krye të qeverisë.

Ndër vite, buxheti i Kosovës është shpenzuar në shumën më të ndryshme për fusha të ndryshme. Gjatë qeverisjes së fundit të udhëhequr nga Albin Kurti, shpenzimet për shërbime të përgjithshme dhe mbrojtje sociale arritën në pika të paprecedentë. Në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme hyn edhe buxheti për pagat e punonjësve publikë. Ndër vite, si numri i punëtorëve, ashtu edhe shumën e buxhetit për

pagat e tyre janë rritur. Gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2024, rreth 600.8 milionë euro u shpenzuan për kompensim të punëtorëve në institucione publike. Në përgjithësi, trendi i rritjes së pagave vërehet edhe jashtë institucioneve publike në Kosovë. Në tetor paga mesatare bruto në vend ka qenë gati 795 euro, krahasuar me mesataren prej 431 eurosh sa ka qenë në vitin 2017.

KRM 'Pastrimi' u bënë thirrje qytetarëve t'i paguajnë faturat e mbeturinave

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kompania Regionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh. a. u ka bërë thirrje qytetarëve t'i paguajnë faturat e mbeturinave në pikat e saj zyrtare. Në njoftimin e kësaj kompanie thuhet se qytetarët e Prishtinës, në bazë të vendimit të miratuar nga Kuvendi Komunal, faturimi dhe pagesa për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave duhet të kryhen drejtpërdrejt në pikat zyrtare të "Pastrimit". "Ky vendim është në fuqi dhe mbetet plotësisht i zbatueshëm. Dëshirojmë të



theksojmë se pezullimi i ndryshimit të rregullores për mbeturinat, i miratuar nga Kuvendi Komunal, nuk mund të bëhet me vendim personal të kryetarit të Komunës, Përparim Rama. Një rekomandim i Zyrës Ligjore të Komunës nuk ka

kompetencë ekzekutive mbi vendimet e Kuvendit Komunal, prandaj çdo veprim në kundërshtim me këtë rregullore është i paligjshëm", thuhet në njoftimin për medie. KRM "Pastrimi" sh. a. apelon qytetarët të mos bien pre e

keqinformimit dhe të kryejnë pagesat e tyre vetëm në "Pastrimi" sh.a.. "Pagesa e faturave është thelbësore për përmirësimin e shërbimit, garantimin e pagave të punëtorëve dhe krijimin e një mjedisi më të pastër për të gjithë. Mos lejoni që keqmenaxhimi dhe interesat financiare të cenojnë cilësinë e shërbimit publik! Paguani faturën tuaj në "Pastrimi" dhe kontribuoni në një Prishtinë më të pastër dhe më të rregulluar!", është theksuar në njoftimin e Kompanisë Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh. a. Komuna e Prishtinës të mërkurën

njoftoi se qytetarët nuk janë të obliguar t'i paguajnë faturat nga ndërmarrja KRM "Pastrimi", dhe se tani e tutje pagesat duhen bërë përmes komunës. "Pas pezullimit të plotësim ndryshimit të rregullores për menaxhimin e mbeturinave njoftojmë të gjithë qytetarët e Komunës së Prishtinës se faturat për grumbullimin e mbeturinave të lëshuara nga Ndërmarrja KRM 'Pastrimi' nga data 1 janar 2025 nuk janë të obliguar t'i paguajnë. Nga tani e tutje, pagesat për këtë shërbim duhet të realizohen përmes Komunës së Prishtinës deri në një vendim të ri", thuhet në njoftimin e komunës së Prishtinës.

BQK-ja shton dy shërbime financiare në platformën shtetërore eKosova

Prishtinë, 6 shkurt - Banka Qendrore e Kosovës, në kuadër të angazhimeve të saj për ta mbështetur lehtësimin e qasjes në financa përmes digjitalizimit të shërbimeve financiare, në pajtim me Planin Strategjik dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), ka vendosur të shtojë në platformën shtetërore eKosova dy shërbime të saj: Regjistrin e Llogarive (RLLB) si dhe Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK). Kjo është e bërë e mundur përmes

nënshkrimit të një Memorandumi të Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve si dhe zhvillimeve të nevojshme teknike. Me këto zhvillime përmes platformës shtetërore eKosova qytetarët pa kosto do të kenë mundësi t'i verifikojnë llogaritë e tyre në institucionet financiare të cilat raportojnë në Regjistrin e Llogarive, duke përfshirë statusin e llogarisë, si dhe mund të përdorin atë për qëllime të nevojave personale

në zbatim të kërkesave të tjera administrative. Gjithashtu, do të kenë mundësi ta nxjerrin Raportin Kreditor individual direkt nga platforma shtetërore eKosova, pa pasur nevojë ta kërkojnë në mënyrë fizike nga BQK-ja. Profili i përdoruesit në platformën eKosova duhet të jetë në nivelin e avancuar të sigurisë (faktor i autentifikimit të dyfishtë), për ta siguruar mbrojtjen e duhur të të dhënave si dhe qasjen e autorizuar vetëm nga pronari i llogarisë.



Po kthehet Lufta e Ftohtë në Arktik?

Trump dëshiron Groenlandën si një bastion për sigurinë e SHBA. Objektivi: të ndalojë Rusinë dhe Kinën, të cilat po zgjerojnë ndikimin e tyre në një Pol të Veriut ku nuk ka më akull



“Për sigurinë kombëtare dhe lirinë në mbarë botën, Shtetet e Bashkuara besojnë se zotërimi dhe kontrolli i Groenlandës janë një domosdoshmëri absolute.” Kjo deklaratë e Donald Trump, e bërë ende pa e marrë detyrën, vuri në alarm gjysmën e Europës. Më pas, ishte djali i tij, Donald Trump Jr., që me vizitën e tij të shkurtër në ishull shkaktoi një furtunë politike: “E dimë si i trajtoni inuitët në Alaskë,” i thanë në aeroportin e Nuuk-ut, duke e pritur me gjeeste fyese. “Groenlanda është e jona, i përket popullit të Groenlandës dhe nuk duam të jemi amerikanë,” sqaroi për të gjithë kryeministri groenlandez, Múte Egede. Ndërkohë, kryeministrja daneze Mette Frederiksen, e cila që në vitin 2019 kishte refuzuar një kërkesë të ngjashme të Trumpit,

përsëriti se ishulli “nuk është në shitje.” E kolonizuar nga vikingët dhe më pas e kaluar në duart e danezëve, Groenlanda është sot një shtet autonom brenda Mbretërisë së Danimarkës, me një qeveri, parlament, gjykatë dhe polici të vetën; vetëm politika e jashtme, mbrojtja dhe financat mbeten në duart e Kopenhagës. Po pse është kaq i rëndësishëm ky ishull për SHBA-në? Mjafton të shikosh një hartë për ta kuptuar. Ky ishull pothuajse i pabanuar, i mbuluar nga akujt në 90% të territorit të tij, është pika e fundit strategjike e NATO-s përpara kontinentit ruso-kinez. Përtej Polit të Veriut shtrihet Arktiku ruso-siberian, me 25,000 kilometra vijë bregdetare, qytete të mëdha si Arkangelsku dhe Murmansku, baza ushtarake, porte, hekurudha dhe

infrastrukturë të rëndësishme. Një sulm ndaj Amerikës mund të vijë vetëm nga ky rajon, duke kaluar mbi Groenlandë, e cila megjithatë është pothuajse e pambrojtur ushtarakisht: përveç bazës amerikane në Pituffik, në skajin verior të ishullit, që është jetike për mbrojtjen nga raketat dhe për komunikimet satelitore, si dhe katër anijeve të Marinës daneze, nuk ka asgjë tjetër. “Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ishulli u vu nën mbrojtjen e Aleatëve. Më pas, gjatë Luftës së Ftohtë, danezët i dhanë SHBA-ve të drejtën për të ndërtuar një bazë ajrore. Por që nga viti 2008, kur groenlandezët morën të drejtën për të menaxhuar në mënyrë të pavarur burimet e tyre natyrore, gjërat kanë ndryshuar,” vëren Robert Peroni, një ish-alpinist nga

Tirol i Jugut, i cili prej dyzet vitesh jeton në Tasiilaq, në bregun lindor, ku ka hapur Casa Rossa, një hotel që ofron edhe të vetmen mundësi punësimi për komunitetin lokal. “Danimarka bën shumë për Groenlandën,” shton ai. “Gjysma e buxhetit të saj varet nga subvencionet e Kopenhagës, që arrijnë mbi gjysmë miliardë euro në vit.” Është e vërtetë që ishulli është i pasur me minerale strategjike, por shfrytëzimi i tyre do të kërkojë vite, për shkak të kushteve të vështira klimatike, logjistike dhe infrastrukturale. “Industria e vetme është peshkimi, edhe pse turizmi po zhvillohet, por vetëm në bregun perëndimor,” përfundon Peroni. Ndërkohë, shkrirja e akujve po e bën Arktikun të lundrueshëm. Rrugë detare dikur të famshme për

ekspeditat epike, si Kalimi i Veriperëndimit, i kryer për herë të parë në fillim të viteve 1900 nga norvegjezi Roald Amundsen, tani janë gjithnjë e më të aksesueshme, jo vetëm për turizmin e kroçerave, por edhe për anijet tregtare. Që nga fillimi i luftës në Ukrainë, cisternat ruse dhe kineze kanë filluar të anashkalojnë sanksionet duke kaluar përmes ujërave arklike. Moska dhe Pekini po përpiqen të zgjerojnë sferat e tyre të ndikimit në rajonin polar duke përfutur nga ndryshimet klimatike. Sepse me një rritje të temperaturave katër herë më të lartë se mesatarja globale (+0.75°C për dekadë), që brenda fundit të kësaj dekade mund të ketë verë pa akull në këtë zonë. Dhe një Arktik “blu”, i përbërë nga det i hapur, përbën një kërcënim edhe për superfuqinë amerikane. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Drita përforcohet me Derrick Bonsu

Klubi gjilanas, Drita e ka zyrtarizuar transferimin e mesfushorit ganez, Derrick Bonsu. “Intelektualët” kanë përforcuar radhët e veta vetëm disa ditë para nisjes

së sezonit pranveror në Albi Mall Superligën e Kosovës. Lojtari i fundit që klubi gjilanas ka nënshkruar me të është mesfushori Bonsu, i cili ka nënshkruar

kontratë të vlefshme për dy vite e gjysmë. “Klubi ynë FC Drita ka nënshkruar me lojtarin ganez Derrick Bonsu. Bonsu luan në pozitën e mesfushorit

defansiv dhe ka nënshkruar kontratë deri në qershor 2027. Ai vjen nga kampionati sllovak ku më parë ka luajtur për ekipet si Pohronie dhe Pdbrezova.

Bonsu do të jetë një opsion shtesë për klubin dhe i dëshirojmë mirëseardhje në familjen tonë bardhë e kaltër”, thuhet në njoftimin e Dritës.

Kosova U-21 mëson kundërshtarët në kualifikimet për ‘Euro 2027’



PRISHTINË, 6 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës U-21 ka mësuar kundërshtarët në rrugëtimin drejt “Euro 2027”. Në shortin e tërhequr në selinë e UEFA-s, “Dardanët” U-21 janë përfshirë në Grupin A kualifikues së bashku me Spanjën, Rumaninë, Finlandën, Qipron dhe San Marinon. Ndeshjet kualifikuese të Grupit A fillojnë nga shtatori

2025 e luhen deri në tetor 2026. Ndeshjen e parë Kosova e luan si mysafire e Rumanisë, më 5 shtator, e më 9 shtator luan në shtëpi kundër favoritit të grupit, Spanjës. Më pas më 14 tetor luan sërish në shtëpi kundër San Marinos, ndërsa vitin e përmbyll me dy ndeshje si mysafire kundër Qipros dhe Finlandës, më 14 e 18 nëntor. Më pas rikthehet në mars të

2026 sipas këtij kalendarit: Kosovë-Rumani (27 mars), Spanjë-Kosovë (31 mars), San Marino-Kosovë (25 shtator), Kosovë-Qipro (30 shtator) dhe Kosovë-Finlandë (6 tetor). Për të arritur në fazën finale të EURO 2027, Kosova duhet të jetë fituese e grupit ose përmes fazës së “play-off”-it si e dyta e grupit, që zhvillohet në nëntor të vitit 2026.

SHKURT

Lazio një muaj pa Hysajn

Skuadra e Lazios do të jetë pa mbrojtësin e krahut, Elseid Hysaj të paktën një muaj. Pas kontrollimeve mjekësore, është konfirmuar lëndimi i Hysajt që e pësoi ditë më parë dhe futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, tashmë ka nisur rehabilitimin. Hysaj u dëmtua në fitoren e Lazios 2:1 ndaj Cagliarit, ditë më parë, ndeshje në të cilën 31-vjeçari bëri edhe një asistim. Ai u detyrua të largohet nga fusha në minutën e 62-të, kurse te Lazio po shpresojnë që Hysaj të jetë i gatshëm pas një muaji apo 45 ditësh. Hysaj ka lënduar muskulin e këmbës së majtë, ndërsa këtë sezon ka regjistruar 6 paraqitje në kampionatin italian dhe ka bërë 2 asistime.

Hamilton: Ky Ferrari, më i mirë se Mercedesi i dy viteve të fundit

Për dy ditë me radhë, pilotët e Ferrarit, Charles Leclerc dhe Lewis Hamilton, kanë testuar gomat e reja Pirelli në pistën e Barcelonës. Nga skuderia italiane zbulojnë edhe ndjesitë e para që ka pasur piloti britanik me “kokëkuqen”, duke shprehur një mendim shumë pozitiv. Ata kanë pilotuar makinën SF-23 (makina e vitit 2023) dhe pavarësisht se ajo nuk ka qenë njëvendëshja më e mirë Ferrari e viteve të fundit mësohet se Hamilton ka thënë se ajo makinë është më e mirë se Mercedesi. “Lewis është ndjerë mirë në makinë”, u shprehën nga Ferrari. “Hamilton ndjehej më mirë në këtë makinë se në Mercedes të dy viteve të fundit. I pëlqenin ndjesitë e drejtimit të makinës dhe aksidenti që pati në ditën e parë erdhi për shkak se ai po testonte makinën në limitet e saj. Testi i parë ishte premtues, tifozët mund të jenë optimist”.

Pensionohet Marcelo

Marcelo ka vendosur të tërhiqet nga futbolli profesionist pas 20 vitesh. Pasi u bë një nga lojtarët më të mirë në rolin e tij mbi të gjitha falë triumfeve të tij me fanellën e Real Madridit (me të cilën fitoi 5 Liga të Kampionëve dhe një mori titujsh të tjerë), ish-lojtari i kombëtares braziliane përfundoi rrugëtimin e tij aty ku filloi në vitin 2005. “Dashuria ime për futbollin vjen nga gjyshi im. Ai donte që unë të bëhesha futbollist profesionist dhe unë bëra gjithçka që munda për ta bërë këtë. Kur isha 18 vjeç, Real Madridi më trokiti në derë dhe u zhvendosa: Mund të them që jam një madrilen i vërtetë. 16 sezone, 25 tituj, 5 Champions League, një nga kapitenët dhe shumë net magjike në Bernabeu, sa çmenduri. Real Madridi është një klub ndryshe”, thotë ai në videon e publikuar në rrjetet sociale në të cilën përshëndet të gjithë.

Sot nis sezoni pranveror në Superligë

Prishtinë, 6 shkurt - Sot (e premte) do të fillojë edhe zyrtarisht pjesa e dytë apo sezoni pranveror në Albi Mall Superligën e Kosovës. Pas rreth dy muajve pushim, futbolli elitari i Kosovës do të rikthehet përsëri me pjesën e dytë të sezonit, ku zhvillohet xhiro

e 19-të. Xhiroja e 19-të ka në program dy ndeshje për t’u zhvilluar të premten, dy tjera të shtunën dhe një të hënën. E diela do të jetë pushim shkaku i zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen në Kosovës. Të premten, Ballkani është nikoqir i

Dukagjinit, teksa Drita e pret Malishevën në Gjilan. Llapi-Gjilani dhe Prishtina-Suhareka do të luajnë të shtunën, teksa ndeshja e fundit e xhiros zhvillohet të jenën mes Ferizajt dhe Feronikelit ’74. Të gjitha ndeshjet pritet të fillojnë nga ora 12:00.





Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Shërbime Juridike” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810190398 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Shërbime Juridike” D.O.O. Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810190398 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Shërbime Juridike” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 810190398 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arjetë Haliti shpall të pavlefshme Diplomën e SH.M.M. “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë, Teknik Laborant.

- Arbnor Likaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl VI - IX shfmu “Pjeter Budi” Lubizhd e Hasit.

- Isen Kabashi shpall te pavlefshme diplomën Q K “11 Marsi” Prizren. Trumza Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11 të “Loyola Gymnasium” Prizren.

- Butrint Hasi B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit 812213480 të lëshuar nga ARBK.

- Vlora Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Zef Lush Marku” Brekoc KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Gani Delijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

